

MARRËVESHJE
NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
QEVERISË SË
MALIT TE ZI
PËR
BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E DIASPORËS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi (në vijim të referuar si “Palët”),

Me dëshirën për të zhvilluar dhe forcuar marrëveshjet dypalëshe ekzistuese ndërmjet dy shteteve me synim për të kontribuar për objektivat gjithëpërfshirëse të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve,

të inkurajuar nga dëshira e përbashkët për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet shteteve të tyre në fushën e diasporës;

të bindur që bashkëpunimi i tyre në fushën e diasporës është një instrument i vlefshëm për forcimin e marrëdhënieve midis shtetasve të tyre:

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

- a. Palët do të mbështesin dhe zhvillojnë bashkëpunimin në fushën e diasporës, ndërmjet dy shteteve në përputhje me parimet e barazisë dhe përfitimit të ndërsjellë.
- b. Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e përvojës dhe programeve në fushën e diasporës.
- c. Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin e drepërdrejtë midis institucioneve përgjegjëse të diasporës që do të realizohet përmes shkëmbimit të vizitave të drejtuesve dhe ekspertëve në fushat e lartpërmendur dhe organizimit të konferencave apo aktiviteteve të përbashkëta.
- d. Sipas mundësive, Palët bien dakord që të punojnë së bashku për një plan të përbashkët veprimi në fushën e diasporës.
- e. Palët do të angazhohen në programe të përbashkëta kulturore për diasporën kudo që do të çmojnë se është e nevojshme.
- f. Palët do të mbështesin bashkëpunimin midis institucioneve të tyre sipas parimeve të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Kombeve të Bashkuara dhe IOM – it.

Neni 2

Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë dhe nuk do të parandalojë të drejtat dhe detyrimet e palëve që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare detruese.

Neni 3

Mosmarrëveshjet, do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve .

Neni 4

Palët, në kuadër të veprimtarive të organizuara në shtetet përkatëse, do të mbulojnë individualisht shpenzimet.

Neni 5

Palët janë dakorduar që kjo Marrëveshje nuk do të përjashtojë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit, të cilat nuk janë specifikuar në të por janë në përputhje me objektivat e saj.

Neni 6

Për qëllim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të krijohet një Komision i Përbashkët (në vijim i referuar si “Komisioni”), i përbërë nga përfaqësuesit e Palëve. Komisioni do të takohet periodikisht në Tiranë dhe në Shkup, në datat e rëna dakord nga të dy vëndet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Komisioni do të përgatisë programet periodike të bashkëpunimit, të cilat do të përcaktojnë detajet dhe kushtet e bashkëpunimit, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe do të vlerësojnë dhe monitorojnë zbatimin e saj, si dhe do të vendosë për rekomandimet e duhura për zbatimin efektiv të saj.

Neni 7

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e pranimit të njoftimit të fundit me shkrim me të cilën palët kanë njoftuar njëra tjetrën, përmes kanaleve diplomatike,

për e kryerjen e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë pesë (5) vjeçare dhe do të rinovohet automatikisht për një periudhë pasuese prej pesë (5) vitesh, vetëm nëse anulohet me shkrim nga njëra Palë përmes kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, Marrëveshja do të përfundojë pas gjashtë (6) muajsh nga data kur Pala tjetër ka pranuar njoftimin e anulimit.

Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e saj do të vazhdojnë të zbatohen për çdo program ose projekt shkëmbimi të iniciuar sipas kësaj Marrëveshjeje dhe që është ende në proces, deri në përfundimin e tyre, përveç kur Palët bien dakord ndryshe.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë dhe me kërkesë të njëjës prej Palëve.

Ndryshimet e miratuara do të hyjnë në fuqi sipas procedurave të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij Neni.

Me anë të kësaj vërtetohet se nënshkruesit e autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje sipas rregullave dhe rregulloreve të qeverive të tyre përkatëse

E nënshkruar në, _____, në datën _____ në dy kopje origjinale secila në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllorj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI**